

Mërgim Korça - Atë Giovanni Fausti, jo vetëm martir i principeve të tij...

Contributed by Jozef Martini
Friday, 19 September 2014

Atë Giovanni Fausti, jo vetëm martir i principeve të tij, por edhe mëndje parashikuese hyjnore!

Mërgim Korça

ME RASTIN E VIZITËS PAPA FRANCESKUT NË VAZHDIM T'ASAJ TË PAPËS GJON PALIT TË II-TË

Atë Giovanni Fausti,

jo vetëm martir i principeve të tij, por edhe

Mëndje Parashikuese Hyjnore !

Mërgim Korça

Po e fillojmë këtë shkrim me si që shprehur Papa Gjon Pali i II-të gjatë vizitës së Tij në Shqipëri, me ç'rast pati thënë : ... “ Historia ende nuk është njohur me ato që kanë ngjarë në Shqipëri ... kësisoji të dashur shqiptarë, në dramën tuaj duhet të jetë i interesuar mbarë kontinenti European nga që është e nevojshme që Europa mos të harrojë.”

Nga ana tjetër nuk ka se si të mos e rikujtojmë përgjatë kësaj hyrjeje pohimin madhor të ish Presidentit Reagan i cili, kur i paten drejtuar pyetjen se ç'ishte fuqija shtytëse e komunizmit, qe përgjigjur shprehimisht : ... “ Është cmira e turmës së paaftë.”

Lidhur me trajtimin e morisë së çështjeve që lidhen me këta dy pohime kanë shkruar analistë si edhe studjues të shquar me ç'rast, sa për të cituar ndonjë syresh, nuk mund të shmangemi pa i përmendur faktet e panumërta të përjetuara në vetë të parë nga shkrimtari i shquar Visar Zhiti, ose dokumentacionet e pafund arkivale të sjella nga Dr.Pjetër Pepa, nga historiani Uran Butka, ose analistët Agim Musta, Fritz Radovani, etj. etj. të cilët kanë sjellë nëpërmjet kujtimeve personale si edhe kujtimeve vjelë nga pjesëmarrës aktivë në ngjarjet e trajtuara ose dokumentash autentike arkivore, të vërteta të cilat ose ishin lënë tërësisht në hije e si vijim krejtësisht në harresë, ose ishin shtrembëruar me themel ! E doemos përgjatë kësaj hullíje nuk mund të lihen, së paku pa u zënë në gojë, fakte që ata vetë “ulërijnë” se si historianë e gjithashtu edhe shkrimtarë pararojë dhe elitarë të dikurshëm të t'ashquajturit Realizëm Socialist, e kanë pretendimin t'a rishkruajnë së rishmi po ata vetë historinë e 47 viteve të diktaturës gjakatare komuniste ! E si po mëtojnë ata t'ia arrijnë këtij qëllimi ? Nga njera anë duke i quajtur gabime të rënda ngjarjet si edhe politikat e shkuara për të cilat ata vetë, si pjestarë të forumit më të lartë partiak përgjatë votimit të vendimeve kishin ngritur lart të dyja duart në shënjë miratimi e sot, me një pafytyrësi të skajëshme e të transformuar në demokratë të shtirë, duan së rishmi të jenë në krye të atyre q'e shkruajnë historinë !

Kësisoji ajo e keqja e përcaktuar me cilësorin egoizëm, të cilën mendimtari i madh Baba Rexhebi e quante e keqja nga më të mëdhat'e njerëzimit, ishte A-ja mbi të cilën u ndërtua ashtuquajturit pushtet popullor demokratik që duhej t'a besonte bota por që nga diktatori i ardhshëm quhej edhe diktatura e proletariatit ! Çfarë absurditeti : ishte shtet demokratik apo diktaturë ?

E pikërisht rreth kësaj cmire të skajëshme që kishte diktatori i ardhshëm si intelektual dështak që ishte, i krahasuar me intelektualët dhe patriotët e mirëfilltë, e mëkuar kjo cmirë pikërisht asaj turmës njerëzore të paaftë, duke qenë mbështetur në faktin që vëndi ynë ishte i shkelur nga këmb'e huaj, nën maskën e s'ashtuquajturës Luftë Nacional Çlirimtare, u kalua në luftë civile. Pikërisht objektivat për t'u arritur, mjetet e përdorura gjatë kësaj lufte, rrjedhojat si edhe pasojat e tyre janë përshkruar nga analistët si edhe studjuesit që zëmë në gojë në fillimin e këtij shkrimi me shitjen totale nga ana e diktatorit të interesave të vëndit shteteve të huaja filluar kjo me Jugosllavinë, vazhduar me B.Sovjetik e në fund Kinës. Krimet e përgjakëshme kryer vetëm me vetëm për t'a mbajtur pushtetin, e në fund mjerimi ekonomik q'e përfshiu vëndin si pasojë të gjithë këtyre faktorëve që u kulmuan me shkërmogjen e komunizmit në Shqipëri mbas shëmbjes së Murit të Berlinit, çuan në atë që u quajt ekzodi popullor shqiptar, çfaqje nga më të shëmtuarat q'i ngjau popullit tone : braktisja e Atdheut !

Për të gjitha këto studjuesit e ardhshëm, duke lexuar shkrimet si edhe analizat që zëmë në gojë, e duke i krahasuar këto edhe me dokumentat arkivale, me aq sa do të mund të gjënden, e duke i lexuar edhe ç'kanë shkruar edhe ish historianët si edhe shkrimtarët e realizmit socialist para 1991-it si edhe në vazhdim, do të dijnë nga ç'kënd vështrimi dhe me ç'sy t'a gjykojnë periudhën e diktaturës në Shqipëri. Ky fakt, deri në një fare mase, na qetëson se e drejta dhe e vërteta do të dalin në shesh. Mirëpo është edhe një anë tjetër e medaljes e cila, duke qenë disi më e padukëshme, ka të ngjarë që t'a mbulojë tisi i harresës. Pikërisht rreth njerës nga këto dukuri do të përqëndrohemi sot.

Duhet të kthehemi me mbrapavështrim në muajin dhjetor të vitit 1945. Arrestohen Patër Giovanni Fausti, Patër Danjel Dajani si edhe Patër Gjon Shllaku, ndërmjet 39 të arrestuarve të tjerë. As dy muaj hetime dhe me 31 janar 1946 fillon gjyqi i tyre. Gjyqi zgjat vetëm tri javë. Si të quhet ... gjyq rrufe ?

Megjithatë studjuesit e ardhshëm i gjejnë si shkresën e cila kërkonte miratimin e vendimeve të marra, (shtatë prej të cilëve me vdekje), e dates 26 shkurt 1946 e gjithashtu edhe shkresën miratuese nga Tirana :

Gjykatës Ushtarake Shkodër

Gjegje shkresës nr. 6-55 datë 26 fruer 1946, e cila miraton vendimet e marra, (me nja dy ndryshime të vogla) dhe e nënëshkruar nga :

Ministri i Luftës dhe Mbrojtjes Kombëtare

Gjeneral Kolonel Enver Hoxha

Po ashtu studjuesit gjejnë edhe Proces-Verbalin e mbajtur nga zv/prokurori Tonin Miloti më 4 mars 1946, ditën e hënë ora 5 të mëngjesit, ku shënohet fjala e fundit e të ekzekutuarve ku, ndëmjete të tjerëve, Patër Giovanni Fausti kishte pohuar :

“Jam kondend se vdekja po më vjen t’u krye detyrën tëme. Dërgoni shëndet jezuitëve, xhakojeve, apostolikëve dhe arqipeshkvit. Rroftë Krishti mbret.”

Ky pohim madhor pak a shumë është bërë nga të gjithë klerikët që janë pushkatuar si pasojë gjyqeve të montuara dhe gjakësore përgjatë diktaturës komuniste.

Mirëpo, së pakut me aq sa kam lexuar unë nga shkrimet e analistëve edhe studjuesve, është një moment nga gjyqi i patër Giovanni Faustit që mungon për t’a bërë më të plotë profilin e Tij madhor. Mua dy pohime të klerikut Jezuit m’i ka pasë rrëfyer vite më vonë Ernest Dema, i dënuar me të njëjtin grup 39 vetash të arrestuar e unë po i rikujtoj :

“... Kur u zhvillue gjyqi në Kinema Rozafatin e Shkodrës, salla e saj ishte e mbushun plot me të ftuem ku në rresht të parë kishin xânë vënd familje dëshmorësh e në vijim funksjonarë shtetnorë e mandej salla ishte e mbushun plot me antarë të partisë komuniste. Kurse jashtë më kanë pasë thënë se kishin vëndue megafonë por qi i hapshin edhe i mbyllshin prej mbrënda sallës simbas dëshirës vrojtuesve të partisë. Ditën kur na të pandehunit kishim m’e thënë fjalën tonë të mrâme, Atë Giovanni Faustin e prûne tue e tërhjekë zharg (zvarrë) dy partizan se aj vetë s’muejte me ecë kah ia kishin thye gjÛjt edhe këmbët një natë më parë në tortura. Kur i erdhi rralla me folë Patër Faustit Aj iu drejtue trupit gjykues më s’pari tue u thënë : -- “ nuk keni m’e besue por mbrâmë, përgjatë tânë natës, un i jam lute Zotit me ju a falë mëkatet se sinqerisht jam i bindun se ju nuk dini se shka bânî !” --

Doemos ky pohim i thënë publikisht në sallën e kinemasë adaptuar si sallë gjyqi si edhe fjala e fundit e Tij para skuadrës së pushkatimit, përbëjnë dëshminë se si Patër Giovanni Fausti shkoi drejt martirizimit të Tij i ndërgjegjshëm sa u takon principeve të Tij. Mirëpo në vazhdim të fjalës së Tij të mrâme, Patër Fausti shprehu me zë të lartë edhe një pikëpamje të Tijën e cila sot, hiç më pak por mbas 68 vitesh, pa asnjë lloj mëdyshjeje nuk do t’ishte e drejtë t’a quanim thjeshtë parashikim por, e thënë nga Ai, thujse ¾ shekulli më pare, si edhe në kushtet e Tij, mund t’a emërtojmë një vegim që iu dha Patër Faustit nga lart e që sa më shumë që kaluan vitet vjen e merr pamjen e një parashikimi hyjnor ...

Mbas pohimit të pare lidhur me lutjet që Patër Fausti i kishte drejtuar Zotit sa i takonte faljes mëkateve të atyre që nuk dinin se ç’bënin, (sipas Patër Faustit), Ernest Dema pati vazhduar e më tregoi pohimin e dytë të klerikut Jezuit Patër Faustit : -- “ E kam bindjen se ju nuk dini se shka bânî kah shtegu t’cillit ia keni hye fillimisht âsht kah ju bân me veprue kundra intelektualve t’mirfilltë e s’bashkut me ata edhe kundra klerit katolik si kleri më i ngritun nga ana intelektuale e prandej fillimisht mjer intelektualët si edhe klerikët ! Në vazhdim mjer të kãmunit ! Mbas tyne mjer klasa katundare se ç’ka me hjekë ! Në vijim, shtegu juej ka me ju çue drejt asaj qi për klasën puntore t’cillën keni m’e krijue, të thuhet mjer ajo ! Përgjatë ksi shtegu mandej

mjer e gjithë kategorija drejtuese e cilla e mbështeti krijimin si edhe forcimin e shtetit të diktaturës proletare e mandej si e verbët ecte mbas gjurmëve të diktatorit ! E s'fundit mjer i gjithë populli !

Për të vënë në dukje se si gjyqi që po trajtojmë rreth klerikëve në Shkodër i filluar me 31 dhjetor të vitit 1945 çonte në vënd flakë për flakë frymën politike zyrtare të P.K. Shqiptare të asaj kohe ku, në Plenumin e V-të të K.Q. të P.K.Sh.-së më 21 shkurt të vitit 1946, Enver Hoxha pati thënë :

“ Nuk e kemi drejtuar popullin tone sa duhet drejt vëllazërimit të shëndoshë me Jugosllavinë, që është një konditë e domosdoshme për ekzistencën e vëndit tone.”

Ja edhe zbatimi i kësaj fryme sipas së cilës prokurori Aranit Çela u drejtonte akuza të pandehurve me ulërime :

“ Të pandehurit kanë shkruar e bërë thirrje për Shqipërinë etnike ! “

Pra kërkesa për bashkim të trojeve shqiptare konsiderohej tradhëti dhe dënohej me vdekje !(?)

Ja edhe një akuzë tjetër e prokurorit gjakatar Aranit Çela :

“ Këte herë populli ka vënë me shpatulla për muri dhe i kërkon llogari një pjese të klerit katolik të cilët...Kanë zhveshur shpatën e tradhëtisë kundër popullit. “

U cituan kalimthi vetëm këta pak fakte që të spikasë se si ne edhe sot mbas 68 vitesh, duke e njohur rrjedhën e historisë, tamam që çuditemi me kthjelltësin'e të parashikuarit të ngjarjeve nga ana e Patër Giovanni Faustit sikur faktet të kishin ndodhur ! Ja edhe një ilustrim akoma m'i përqëndruar. Zoi Themeli ishte aso kohe Kryetar i Degës së Brendëshme të Shkodrës. Gjakatar dhe torturues i tmerrshëm. Ai me hetuesit e tij e katandisën Patër Faustin t'a tërhiqnin zvarrë kur e futën në sallë se ia kishin thyer të dyja këmbët me tortura. E Patër Fausti, në ato kushte e shikonte si një vizion se si Zoi Themeli do të internohej familjarisht nga partija e tij komuniste e, duke qen'i internuar në Çermë të Lushnjës jo vetëm që iu vetëvar atje edhe e bija por ai së bashku me ministrat e brëndshëm të pushkatuar që nga Koçi Xoxi e në vazhdim ... do të katandiseshin në të mjerë se çdo t'i gjente në të ardhmen nga egoizmi i diktatorit ! Prandaj, shikuar me sytë si edhe njohuritë tona të sotme, jo vetëm që na mahnit kthjelltësija e drejtëpeshimit e në vazhdim e parashikimit të ngjarjeve nga ana e Patër Giovanni Faustit sa që, të trembur se mos koha do t'a mbështjellë me një tis harrese këtë fakt e nuk do t'a radhisë mes fakteve historike, duam që realiteti i përjetuar nga Ernest Dema me shokë të trashëgohet. Kësisoji studjuesit e ardhshëm t'a kenë edhe një pike reference për atë periudhë ku mes atyre që do të pushkatoheshin, veç për hir të egoizmit të diktatorit, martiri Patër Giovanni Fausti, lidhur me qëndrimet e Tija, mund të thuhet me plot gojën, se që një Shënjtore ende i pashpallur !

Prej arkivit të Albanovaonline:

- Giorgio Silvestri, Giovanni Fausti (1899-1946)

- Pjetër Pepa, 4 mars 1946, pushkatohej At Gjon Fausti, At Daniel Dajani, Pater Gjon Shllaku, seminaristi Mark Çuni...

